



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 14.03.2023

Nr: 23

Ora: 09:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 30, DATË 11.03.2023 TË SUBJEKTIT
“LËVIZJA BASHKË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 14.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia “Lëvizja Bashkë”, përfaqësuar nga z. Arlind Qorri

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 157, datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike ‘Lëvizja Bashkë’ me kryetar z. Arlind Qorri, me shkronjat nistore ‘Bashkë’, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023 ”.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”; 123/1; 124 dhe 134 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Partia “Lëvizja Bashkë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Arlind Qori, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr.157, datë 09.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja Bashkë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, vendosi mosregjistrimin si subjekt zgjedhor partinë politike “Lëvizja Bashkë”, me arsyetimin se nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, pasi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e partisë “Lëvizja Bashkë” nuk është i formës së prerë e si rrjedhojë nuk është i pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti ankues “Lëvizja Bashkë”. Në këtë kërkesë pretendon se:

Neni 9 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar përcakton se: *Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.*

Në vendimin nr.2, datë 02/03/2023 është miratuar njohja e partisë politike “Lëvizja Bashkë” si person juridik, si dhe është urdhëruar regjistrimi i saj në Regjistrin e Partive Politike. Kjo tregon se nga ana formale është përmbushur detyrimi ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 maj 2023. Data kur gjykata ka miratuar njohjen e partisë politike “Lëvizja Bashkë” si person juridik është data 02/03/2023, që përmbush nga ana formale kriterin e përcaktuar në germën “a” të pikës së dytë të nenit 64, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Referuar praktikës së Komisionit Qendror Zgjedhor me vendimin nr. 230, datë 27/04/2019, ku është vendosur: - “Regjistrimi i partisë “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”, në mënyrë kolegjiale është pranuar shqyrtimi për regjistrimin e kësaj partie vetëm me kërkesën për regjistrim drejtuar Gjykatës, dhe në seancën publike të Komisionit Qendror Zgjedhor partia politike ka dorëzuar Vërtetim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të njëjtë me atë të dorëzuar nga ana jonë. Ky dokument është pranuar nga ana e institucionit të KQZ-

së gjatë seancës publike për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, si conform kriterit të përcaktuar në germën "a" të pikës 2 te nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

4. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 14.03.2023, ora 09:00.
5. Gjatë seancës publike të shqyrtimit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, përfaqësuesi i partisë "Lëvizja Bashkë" z. Arlind Qorri parashtrroi se:

"Në datën 09/01/2023 janë dorëzuar në gjykatë firmat e mbledhura dhe gjithë dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e partisë politike "Lëvizja Bashkë". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të kishte marrë vendimin me datë 9 shkurt, por në mënyrë të qëllimshme e ka marrë atë në datën 2 mars 2023, përtej afateve ligjore. Në data të ndryshme i jemi drejtuar Gjykatës për t'u shprehur në kohë mbi regjistrimin e partisë politike.

Me datën 6 mars kemi dorëzuar dokumentacionin e plotë pranë KQZ për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor.

Neni 9 i ligjit "Për partitë politike" flet vetëm për një datë miratimi dhe regjistrimi të partisë politike, që në rastin tonë është data 2 mars 2023 e vendimit të gjykatës. Nëse i referohemi nenit 15 të ligjit "Për partitë politike", gjykata e konsideron të regjistruar partinë tonë që nga momenti i miratimit të saj. Ajo mund ta çregjistrojë atë në momentin e ankimimit nëse ka të tillë brenda afatit 15 ditor nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi. Vendimi i Komisionerit, që citon se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i formës së prerë, është i padrejtë".

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Vendimin nr.157 I Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ,datë 09.03.2023
 - Kërkesën ankimore nr.30 datë 09.03.2023
 - Shkurtim-Vendimi nr.2, datë 02.03.2023 për regjistrimin e partisë politike "Lëvizja Bashkë".

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Partitë politike janë një formë organizimi social, ku një grup personash me pikëpamje, bindje dhe interesa politike të përbashkëta, të cilët kanë për qëllim ndikimin në jetën e vendit, mblidhen dhe organizohen, për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të përfaqësuar popullin në organet e zgjedhura të pushtetit.

2. Mënyra e krijimit dhe organizimit të partive politike në Republikën e Shqipërisë rregullohet në ligjin nr. 8580, datë 17.02.200 "Për Partitë Politike". Neni 9 i ligjit për partitë politike parashikon se regjistrimi i partive politike bëhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila mban regjistrin e partive politike. **Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.**

Pra, ligji kërkon plotësimin e dy kushteve kumulative në mënyrë që partia politike të fitojë personalitet juridik. Këto dy kushte plotësohen në momente të ndryshme.

- Kushti i parë ka të bëjë me miratimin e partisë politike dhe konsiderohet i plotësuar në ditën që gjykata del me vendim për krijimin e partisë politike, vendim të cilin duhet ta marrë brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës.
- Kushti i dytë ka të bëjë me regjistrimin e partisë, që ndodh 15 ditë nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës, që është dita kur ky vendim merr formë të prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm. Në këtë moment, ky vendim pasqyrohet në regjistrin e partive politike.

3. Vetëm pas plotësimit të të dy kushteve të mësipërme, konsiderohet se partia politike gëzon personalitet juridik për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

Deri në plotësimin e të dyja kushteve kumulativisht, partia nuk ka tagër për të kryer veprime juridike, përveç veprimeve të nevojshme për organizimin e saj, siç janë mbledhja e themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese të partisë; sipas parashikimit të paragrafit të tretë në nenin 9 të ligjit "Për partitë politikë".

Për shkak se i mungon personaliteti juridik, "Lëvizja Bashkë" ende nuk mund të veprojë juridikisht me kërkesa që obligojnë palët e treta. Depozitimi i kërkesës për regjistrim në zgjedhje mund të bëhet vetëm pasi partia të ketë fituar zotësinë për të vepruar. Partia politike nuk krijohet për të marrë pjesë në një palë zgjedhje. Ajo krijohet për të ndikuar në formimin e vullnetit politik të zgjedhësve në dekada. Për këtë arsye nuk justifikohet dot ligjërisht zgjedhja emergjente, jashtë kushteve dhe kriterëve ligjore, që kërkon ankuesi.

4. Përfaqësuesi i subjektit ankues ngriti pretendimin në seance se: *"ekziston një precedent i ndjekur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vitin 2019 për regjistrimin e partisë 'Bindja Demokratike' si subjekt zgjedhor"*.

Një tjetër rast i ngjashëm, por me tjetër vendimmarrje, i shqyrtuar nga KQZ, është vendimi nr. 158/2015 për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Shkodra 2015" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, ku KQZ vendosi mosregjistrimin e kësaj partie për shkak se vendimi i regjistrimit të partisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kishte marrë formë të prerë në momentin e paraqitjes së kërkesës në KQZ.

KAS arsyeton se sistemi ligjor shqiptar sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nuk është sistem që bazohet mbi precedentin, por sistem që bazohet në ligjin e shkruar. Kështu, vendimet e marra më parë nga KQZ nuk janë të detyrueshme për vendimmarrjen e KAS. Për më tepër, edhe doktrina juridike për precedentin gjyqësor/administrativ nuk e pranon arsyetimin e ankuesit rreth precedentit. Precedenti sipas kësaj doktrine bëhet i tillë vetëm kur jurisprudenca krijon traditë në zgjidhjen e njëlojtë të konflikteve të ngjashme në një periudhë kohore të konsiderueshme. Dy zgjidhje të kundërta për dy çështje të ngjashme të dhëna nga i njëjti organ nuk formojnë dot precedent.

5. Për gjithë sa me sipër, në momentin e shqyrtimit të kërkesës në KAS, subjekti ankues “Lëvizja Bashkë” nuk rezulton i regjistruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nuk është plotësuar ende afati 15 ditor nga data 02.03.2023 që është dita e shpalljes së vendimit të gjykatës. Për këto arsye, ky subjekt nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023.

KQZ nuk mund të analizojë dhe gjykojë rreth praktikës së gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm lidhur me zbatimin e afateve procedurale. KAS-i sidomos nuk mund të mbështesë vendimmarrjen e tij tek argumenti se “vonesa” në përmbylljen e procedurave të regjistrimit nuk ka ardhur për faj të ankuesit dhe prandaj ai nuk mund të ndëshkohet për këtë shkak. Mosregjistrimi në zgjedhje është një fakt juridik i veçantë, i cili nuk ka shkak “vonesën” në regjistrim, por ka shkak mungesën e personalitetit juridik dhe të zotësisë për veprim, të cilat janë kushte që nuk mund të anashkalohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 30 të Vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, me shumicë votash, KAS

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 30, datë 11.03.2023 të paraqitur nga subjekti “Lëvizja Bashkë”;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 157, datë 09.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrim Lëvizja Bashkë”;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis ÇEFA	-	Relator	(Kundër)
Elvin LAKO	-	Anëtar	
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar	
Koli BELE	-	Anëtar	
Ledio BRAHO	-	Anëtar	(Kundër)

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 30 të paraqitur nga partia “Lëvizja Bashkë” me objekt *“1. Kundërshtimin e vendimit Nr. 157, datë 09.03.2023, ora 10:00 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Lëvizja Bashkë” me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “Bashkë”, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023”,* ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte pjesërisht ankimin e paraqitur nga Partia “Lëvizja Bashkë” dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 157, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.

2. Rezulton i provuar fakti se anëtarët themelues të partisë politike “Lëvizja Bashkë”, kanë respektuar parashikimet e ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, në drejtim të marrjes të të gjitha masave organizative për të plotësuar kërkesat e nevojshme dhe për të kryer procedurat e tjera që ligji parashikon për krijimin dhe regjistrimin e partisë politike. Rezulton i provuar fakti se anëtarët themelues kanë qenë aktivë në marrëdhënien me Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë edhe në drejtim të përlllogaritjes së saktë të kohës së nevojshme për gjykatën, që në respektim të parashikimeve të nenit 13¹ të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, të shqyrtonte dhe miratonte kërkesën për regjistrimin e kësaj partie duke i lënë mjaftueshëm afat në dispozicion asaj (partisë) për t’u regjistruar më pas në KQZ si subjekt zgjedhor, sipas parashikimit të nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Më konkretisht anëtarët themelues të Partisë “Lëvizja Bashkë” e kanë dorëzuar kërkesën në gjykatë në datën 09.01.2023, kërkesë e cila është regjistruar në datën 12.01.2023 dhe sipas nenit 13 pika 1 të ligjit të sipërcituar, gjykata duhet të ishte shprehur me vendim përfundimtar jo më vonë se data 11.02.2023.

3. Është i provuar fakti që Gjykata e Shkallës së parë Tiranë ka caktuar seancë për shqyrtimin e kësaj kërkesë në datën 02.03.2023 dhe e ka pranuar atë me vendimin nr. 2, datë 02.03.2023, pra dukshëm në tejkalim të afatit 30 ditor të parashikuar në ligjin e posaçëm për partitë politike. Në këtë

¹ “Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji”.

kontekst është i qartë fakti që Partia “Lëvizja Bashkë” nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi lidhur me tejkalimin e afateve ligjore nga gjykata për shqyrtimin e kërkesës së saj.

4. Është i provuar fakti se partia Lëvizja Bashkë ka depozituar pranë KQZ kërkesën për regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor brenda afateve të parashikuara në nenin 64 të Kodit Zgjedhor, bashkë me dokumentacionin shoqëruës, por që për shkak të mostejkalimit të afatit 15 ditor nga data e shpalljes së vendimit² të gjykatës për regjistrimin e saj, vendimi nuk kishte marrë formë të prerë si në datën e shqyrtimit të kërkesës për regjistrim si subjekt zgjedhor pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu edhe në datën e shqyrtimit të kërkesës ankimore pranë KAS. Për rrjedhojë, rezulton se subjektit ankimues i mungon dokumenti i parashikuar nga neni 64 pika 2 shkronja “a” i K.Zgjedhor që është *“vërtetimi që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

5. Në nenin 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar parashikohet se *“Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.”*. Në nenin 3 të po këtij ligji parashikohet se *“Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.”*. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që përcakton parimet themelore të saj, parashikon se *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*. Neni 9 i Kushtetutës parashikon se *“Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.”*. Neni 45 pika 1 i Kushtetutës parashikon se *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.”*. Ndërsa neni 46 i Kushtetutës, në pikat pika 1 dhe 2 të tij parashikon se *“1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.”*

² Neni 15 i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar parashikon se *“Vendimi i gjykatës për regjistrimin ose mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit të gjykatës”*.

6. **Pluralizmi është një nga bazat e shtetit shqiptar dhe ky i fundit ka për detyrë ta respektojë dhe ta mbrojtë atë. Po ashtu partitë politike dhe krijimi i tyre, janë subjekte që gëzojnë mbrojtje kushtetuese për vetë faktin se janë baza e pluralizmit politik në vend.** Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, ka theksuar se “... pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme” dhe “Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor”.³ Po ashtu, në të njëjtën vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese është cituar se “Në koncept, parimi i konkurrimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë”. **Ne anëtarët në pakicë të KAS vlerësojmë se anëtarët themelues të Partisë “Lëvizja Bashkë” i kanë marrë të gjithë masat e duhura për regjistrimin e partisë politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke konsideruar si afatin 30 ditor si afat maksimal për regjistrimin e partisë politike, por po ashtu edhe afatin 15 ditor që vendimi i gjykatës të merrte formën e prerë. Vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor, nuk mund të çënojë pluralizmin qoftë ky dhe për zgjedhje vendore, ndaj vendimmarrja e KAS duhet të orientohet drejt zgjidhjes për regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.**

³ CZE-2000-1-002 (Codices).

7. Për ne anëtarët në pakicë, ekziston mundësia që kjo parti politike të regjistrohet për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe të jetë në afat për depozitimin e listave të kandidatëve në përputhje me nenin 67 të K.Zgjedhor⁴ (25.03.2023). Më konkretisht, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin si parti politike i Partisë “Lëvizja Bashkë” është shpallur në datën 02.03.2023. Në rast se ky vendim nuk ankimohet deri në datë 17.03.2023, atëherë, në zbatim të nenit 451 të K.Pr.Civile, ai merr formë të prerë dhe Partia “Lëvizja Bashkë” regjistrohet në Regjistrin e Partive Politike që mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pikërisht ky është dhe momenti që kjo e fundit mund të lëshojë dokumentin e parashikuar nga neni 64 pika 2 shkronja “a” i K.Zgjedhor që është “*vërtetimi që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë*”.

8. **Në vijim të arsyetimit të mësipërm, KAS kishte dy mundësi për të respektuar dhe mbrojtur pluralizmin në vend:**

a. Në zbatim të neneve 135 pika 6⁵ dhe 136 pika 2⁶ të K.Zgjedhor, të ndërpriste seancën e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore objekt shqyrtimi dhe në datën 18.03.2023 të kërkonte nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nëse vendimi i kësaj Gjykate për regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” kishte marrë formë të prerë; ose

b. Në zbatim të nenit 102 pika 1 shkronjat “a” dhe “b” të K.Pr.Administrative⁷, të detyronte Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për nxjerrjen e një akti administrativ dobiprurës në lidhje me regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

9. Duke qenë se qëllimi që një parti politike të regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore është pjesëmarrja në zgjedhje me kandidatë për kryetarë të njësisive të qeverisjes vendore dhe lista të kandidatëve për këshillat vendorë dhe duke qenë se në zbatim të

⁴ “1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmbrojtore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore **jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.**

Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve”.

⁵ “6. Pasi merr vendim për kërkesat paraprake të palëve dhe në rast se ato nuk sjellin pushimin e shqyrtimit administrativ, KQZ-ja shqyrton dhe zgjidh çështjen në themel, pa ndërprerë seancën. Seanca ndërpritet vetëm kur është e nevojshme marrja e provave nga të tretë”.

⁶ “2. Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, KQZ-ja, me kërkesë të secilës prej tyre ose kryesisht, mund të vendosë marrjen e provave të tjera kur çmon se marrja e tyre është në dobi të gjykimit”.

⁷ “1. Një akt administrativ dobiprurës mund të shoqërohet me një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme shtesë:

a) një ngjarje, e cila nuk është e sigurt se do të ndodhë dhe me ndodhinë e së cilës varet fillimi apo fundi i një të drejte, përfitimimi ose barre (kushti);

b) një datë ose një periudhë kohore, në të cilën një e drejtë, një përfitim ose barrë, përkatësisht do të fillojë, përfundojë ose zgjasë”.

nenit 67 të K.Zgjedhor, afati për depozitimin e këtyre kandidaturave për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, është data 25.03.2023, atëherë nëse konfirmohet që në datë 18.03.2023 vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” ka marrë formë të prerë, është mundësia për regjistrimin e kësaj partie politike si subjekt zgjedhor pa cënuar asnjë të drejtë tjetër që ajo të konkurrojë në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

10. Ne anëtarët në pakicë të KAS, vlerësojmë se në zbatim të neneve 135 pika 6 dhe 136 pika 2 të K.Zgjedhor KAS, e kishte mundësinë që në datë 18.03.2023 të vlerësonte nëse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” kishte marrë formë të prerë apo jo (dhe në rast marrje formë të prerë do të administrohej si provë dhe vërtetimi nga Regjistri i Partive Politike) dhe në varësi të këtij kushti të vlerësonte nëse do ishin kushtet për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë “Lëvizja Bashkë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Po ashtu, një zgjidhje tjetër alternative që për ne anëtarët në pakicë të KAS, është ajo e detyrimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për nxjerrjen e një akti administrativ dobiprurës “Regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “Bashkë”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. në zbatim të nenit 102 të K.Pr.Administrative që të shoqërohej me dy kushte kumulative shtesë:

- a. Kushti i parë, në zbatim të pikës 1 shkronja “a” të këtij neni, do të ishte ai i marrjes formë të prerë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e Partisë “Lëvizja Bashkë” dhe depozitimi pranë KQZ i vërtetimit nga Regjistri i Partive Politike; dhe
- b. Kushti i dytë, në zbatim të pikës 1 shkronja “b” të këtij neni, do të ishte depozitimi pranë KQZ i vërtetimit nga Regjistri i Partive Politike në datë 18.03.2023.

11. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi “Lëvizja Bashkë” është pjesërisht e bazuar dhe ajo duhej të ishte pranuar pjesërisht nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte shfuqizuar vendimi nr. 157, datë 09.02.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho

MENDIM SHITESË I ANËTARIT NË PAKICË ELVIS ÇEFA

KQZ ka mbajtur në vite dy qëndrime të ndryshme lidhur me kërkesat për regjistrim si subjekt zgjedhor të partive politike vendimi gjyqësor për regjistrimin e të cilavenuk ishte i formës së prerë. Konkretisht

- Me vendimin nr. 158, datë 16.4.2015 KQZ ka vendosur të mosregjistrojë partinë “Shkodra 2015” si subjekt zgjedhor,
- ndërsa me vendimin nr. 230, datë 27.4.2019 KQZ ka vendosur të regjistrojë partinë “Bindja Demokratike” si subjekt zgjedhor.

Në këtë kontekst, vlerësoj se do të ishte me vend që KAS të unifikonte qëndrimin e KQZ për këto raste, duke respektuar përsa është e mundur parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit.

Ndryshe nga vendimi i parë i KQZ i cituar më lart, vendimi i dytë që i përket subjektit Bindja Demokratike, ka krijuar pasoja juridike dhe politike. Konkretisht, bazuar në këtë vendim, subjekti në fjalë është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, emri dhe logo e tij janë shënuar në fletën e votimit, subjekti ka prodhuar një rezultat zgjedhor në ato zgjedhje duke bërë të mundur që të ketë edhe këshilltarët e tij në disa Këshilla Bashkiake në vend.

Në këtë kontekst, mosregjistrimi i ankuesit Lëvizja Bashkë si subjekt zgjedhor do të përbënte aplikimin e një standarti të dyfishtë nga KQZ dhe njëkohësisht do të ishte një cënim i parimit të barazisë përpara ligjit kundrejt subjektit politik Lëvizja Bashkë, kundrejt anëtarëve të tij themelues por edhe kundrejt zgjedhësve të këtij subjekti të cilët do të privoheshin padrejtësisht nga e drejta kushtetuese për të votuar për këtë subjekt politik.

Anëtari: Elvis Çefa